

Sfidat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë



Komentar

“Sfidat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë ”

**Nëntor 2013
Prishtinë**

Sfidat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë

Hyrje

Sipas Ligjit të Punës, femrat e punësuara në Kosovë gëzojnë të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë. Kjo e drejtë vlen për femrat e punësuara në sektorin publik dhe privat, përfshirë edhe sektorin e shoqërisë civile. Tashmë po bëhen gati 3 vite nga miratimi i këtij ligji dhe dispozita që e përcakton pushimin e lehonisë raportohet që nuk është duke u zbatuar si duhet, kryesisht nga punëdhënësit që nuk i takojnë sektorit publik. Bazuar në këto raporte, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka filluar procedurat për plotësim-ndryshimin e këtij ligji, konkretisht dispozitës për pushimin e lehonisë.

Përderisa raportohet se sektori privat po ballafaqohet me vështirësi në zbatimin e kësaj dispozite ligjore¹, situatë edhe më problematike paraqitet në sektorin e shoqërisë civile, për shkak të vet natyrës specifike të punës dhe financimit të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Duke marrë shkas nga raportimet e fundit në medie për problemet lidhur me të drejtën për pushim të lehonisë për femrat e punësuara në organizatat e shoqërisë civile², dhe me qëllim që të nxitet një debat konstruktiv rreth kësaj çështjeje që do të ndikojë në procesin e plotësim-ndryshimit të Ligjit të Punës, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) më poshtë synon që të ngrisë disa çështje specifike të sektorit civil në Kosovë në raport me të drejtën dhe pagesën për pushimin e lehonisë, të cilat duhet të diskutohen gjatë procesit të plotësim-ndryshimit të Ligjit të Punës.

Përshkrimi i çështjes

Sipas Nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212³, femrat e punësuara në Kosovë gëzojnë të drejtën prej dymbëdhjetë muajve, të pushimit të lehonisë, gjatë të cilave paga për gjashtë muajt e parë i paguhet nga punëdhënësi në vlerë të 70% të pagës bazë, në tre muajt në vijim nga Qeveria e Kosovës në vlerë të 50% të pagës mesatare në Kosovë, si dhe tre muajt e fundit si pushim pa pagesë.

Neni 49

Pushimi i lehonisë

1. Femra e punësuar gëzon të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë.
2. Me prezantimin e certifikatës mjekësore femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në dyzetepesë (45) ditë para datës kur pritet të lindë. Në periudhën prej njëzetetë (28) ditëve para datës kur pritet të lindë, punëdhënësi me pëlqimin e femrës shtatzënë, mund të kërkojë që ajo ta fillojë pushimin e lehonisë, nëse punëdhënësi mendon se femra e punësuar nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e saj.
3. Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë.
4. Tre (3) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë .

¹ Zeka & Hapçiu, "Agjenda e Biznesit të Kosovës 2011", Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, 2011

² <http://zeri.info/artikulli/19769/clard-nuk-paguan-pushimin-e-lehonise>

³ I miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 1 nëntor 2010 dhe publikuar në Gazetën Zyrtare më 1 dhjetor 2010, marrë nga [http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20i%20Punes%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20i%20Punes%20(shqip).pdf)

Sfidat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë

5. Femra e punësuar ka të drejtë me këtë ligj që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muaj të tjera pa pagesë.

6. Nëse lehona nuk dëshiron ta shfrytëzoj të drejtën në pushim të lehonisë nga paragrafi 4. dhe 5. I këtij neni, duhet ta lajmëroj punëdhënësin më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të pushimit, nga paragrafi 3. i këtij neni.

7. Babai i fëmijës mund të marrë të drejtat e nënës, nëse nëna vdes ose e braktis fëmijën para se të përfundojë pushimi i lehonisë.

8. Të drejtat nga paragrafi 4. dhe 5. i këtij neni mund të barten te babai i fëmijës në marrëveshje me nënën.

Këto dispozita janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, të përcaktuara nga Konventa Nr. 183 e Organizatës Botërore të Punës (ILO)⁴, që përcakton që shtetet duhet t'u ofrojnë lehonave një pushim të lehonisë në kohëzgjatje prej të paktën 14 javësh dhe me një pagesë prej të paktën 2/3 e pagës bazë.

Duke qenë se gjatë kohës kur lehona është në pushim, dikush tjetër duhet ta bëjë punën e saj dhe të paguhet për këtë punë, zbatimi i këtij ligji në praktikë nënkupton që secili punëdhënës duhet të ketë në dispozicion një fond shtesë që do të mundësonte pagesën e 70% të pagës bazë gjatë gjashtë muajve të parë. Institucionet publike që financohen nga buxheti shtetëror mund ta ndajnë këtë fond nëpërmjet një planifikimi ose rishqyrtimi buxhetor. Bizneset private themelohen dhe operojnë për të nxjerrë fitime nga puna e tyre, dhe këtë fond shtesë mund ta ndajnë nga fitimi i tyre.

Për dallim nga institucionet publike dhe bizneset private, organizatat e shoqërisë civile nuk gjenerojnë fitim dhe shumica dërrmuese e tyre nuk kanë fonde të lira të cilat do të mund të përdoreshin për të mbuluar shpenzimet e pagës për lehonën. Kjo situatë vjen për shkak të vet natyrës së financimit të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, dhe jo vetëm.

Sipas të dhënave të fundit të Indeksit Kosovar për Shoqëri Civile⁵, përqindja më e madhe e burimeve financiare për shoqërinë civile në Kosovë vjen nga donatorët e huaj me 74.0%, e pasuar nga institucionet lokale dhe qendrore që sigurojnë 20.5% të fondeve të shoqërisë civile në Kosovë. Vetëm 0.2% të fondeve të shoqërisë civile në Kosovë sigurohen nga shërbimet që këto organizata i ofrojnë. Forma bindshëm më e shprehur e financimit vazhdon të mbeten grantet për projekte, dhe atë në kohëzgjatje deri në 1 vit (56.6%) apo deri në 2 vite (36.8%). Si rrjedhojë, kohëzgjatja e qëndrimit të të punësuarëve në organizatë është më e shkurtër se 2 vite, në 49.5% të rasteve. Për më tepër, më shumë se gjysma e organizatave të shoqërisë civile i takojnë grupit të organizatave më qarkullim vjetor nën 50,000 EUR (gjysma e të cilave nën 10,000 EUR), e të cilat fondet e tyre i sigurojnë ose nga grante të vogla për projekte, ose nga fondet shtetërore, kryesisht të nivelit komunal.

⁴ International Labour Organization (ILO) C183 - Maternity Protection Convention, 2000 (No. 183) - Convention concerning the revision of the Maternity Protection Convention (Revised), 1952 (Entry into force: 07 Feb 2002) – Adopted in Geneva, 88th ILC session (15 Jun 2000)

⁵ Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është një studim i rregullt i gjendjes së sektorit të shoqërisë civile në Kosovë që bëhet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Edicioni i vitit 2013 pritet të publikohet në Dhjetor 2013.

Sfidat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë

Grantet për projekte, si rregull, jepen për të përmbushur një qëllim konkret, dhe si të tilla i mbulojnë shpenzimet për aktivitetet specifike dhe punën e bërë për t'i realizuar pikërisht ato aktivitete. Më konkretisht, për secilin projekt, ekziston një kontratë mes organizatës dhe donatorit që i përcakton shpenzimet e lejuara në bazë të vijave specifike buxhetore, duke përfshirë edhe pagat e veçanta për secilin të punësuar që i zbaton ato aktivitete. Për më tepër, secili projekt e ka kohëzgjatjen e caktuar dhe në momentin e përfundimit të projektit specifik, pagesa e të punësuarëve përfundon, përveç se në rastet kur organizata ka projekte tjera të financuara dhe i angazhon të punësuarit e njejtë. Edhe pse kontratat bëhen në mes të organizatës dhe të punësuarit, në të vërtetë, shumica e të punësuarëve në sektorin civil kontratat e tyre i kanë të lidhura në raport me projektin, e jo organizatën. Kjo nënkupton që këta të punësuar pagën e marrin për punën e bërë në aktivitetet specifike të projektit, e jo për organizatën në përgjithësi. Si rrjedhojë, numri më i madh i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë e kanë të pamundur që të paguajnë ndonjë punëtor i cili nuk e bën punën konkrete për të cilën është dhënë granti, përfshirë edhe lehonat. Kjo bën që organizatat e shoqërisë civile, jashtë kontrollit të tyre, të mos kenë mundësi që t'i garantojnë të gjitha të drejtat e femrave e punësuarat që mund të lindin gjatë periudhës së punësimit në këto organizata.

Gjithashtu, ky problem i dëmton edhe vet organizatat e shoqërisë civile në tërheqjen e stafit të kualifikuar dhe profesional. Përderisa në një numër të madh të organizatave të shoqërisë civile njerëzit angazhohen në baza vullnetare dhe në shumicën e rasteve si angazhim dytësor, një numër gjithnjë në rritje i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë ka filluar të specializohet dhe të angazhojë staf profesional dhe me nivel të lartë të ekspertizës. Angazhimi i profesionistëve kërkon që përveç tjerash, punëdhënësi të ofrojë edhe një perspektivë më të gjatë punësimi dhe një ofertë konkurruese në treg sa i përket të drejtave dhe përfitimeve të të punësuarit. Kur është fjala për profesioniste femra të cilat planifikojnë të lindin fëmijë, organizatat e shoqërisë civile janë në një pozitë të dobësuar konkurrence në raport me sektorin publik dhe atë privat.

Përfundimi

Kjo situatë shkakton një vakum ligjor dhe i sjell organizatat në një pozicion të shkeljes së dyfishtë sa i përket pagesës së pushimit të lehonisë. Sikurse të gjithë punëdhënësit tjerë të Kosovë, edhe organizatat e shoqërisë civile e kanë obligim që t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë. Në anën tjetër, duke qenë të lidhura nga obligimet kontraktuale me donatorët që i financojnë projektet e tyre, këto organizata nuk kanë asnjë mënyrë të ligjshme për t'i siguruar mjetet financiare për ta zbatuar këtë obligim ligjor. Aktualisht, në shumicën e rasteve alternativa e organizatave mbetet që ose ta shkelin Ligjin e Punës, ose ta shkelin marrëveshjen me donatorët në raport me vijat specifike të buxhetit të financuar. Në rast të shkeljes së Ligjit të Punës, ato rrezikojnë që përveç pagës së papaguar, të sanksionohen edhe me pagesën e dëmshpërblimit shtesë – e duke mos pasur nga t'i marrin mjetet as për pagë e as për dëmshpërblim, mund të bëhen josolvente dhe të mbyllen në tërësi. Ngjashëm, duke e shkelur marrëveshjen me donatorin, organizatat mund të vijnë në pozitë që t'u ndërpritet financimi dhe të rrezikojnë financimin e projekteve të ardhshme të tyre, duke e dëmtuar qëndrueshmërinë e organizatës së tyre.

Në këtë situatë, organizata të shoqërisë civile mund të zgjedhin alternativën më të padëshirueshme për të gjithë, duke hezitur që të punësojnë femra shtatëzëna ose që mund të mbesin shtatëzëna në

Sfidat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë në zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë

një të ardhme të afërt. Ky diskriminim potencial i kësaj kategorie mund të sjellë efekte të kundërta me qëllimin e vërtetë të ligjit, në raport me të drejtat e lehonave.

Rruga përpara

Asnjëra nga këto nuk duhet të ndodhë dhe për këtë duhet angazhim i institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe komunitetit të donatorëve në Kosovë. Për të gjetur zgjidhjen më të mirë duhet që të hapet një debat konstruktiv dhe gjithëpërfshirës, ku secili sektor të identifikojë dhe shpalosë mënyrat në të cilat mund të kontribuojë.

Si një sektor që zë një pozicion shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe operimin e shoqërisë civile në Kosovë, komuniteti i donatorëve të huaj ka një rol specifik në këtë debat, duke pasur parasysh dhe adresuar obligimin e organizatave të shoqërisë civile ndaj zbatimit të legjislacionit vendor, përfshirë edhe çështjen e pushimit të lehonisë.

Për t'u zhvilluar një debat që do të prodhonte zgjidhje të favorshme për të gjithë, KCSF mendon që duhet të merren parasysh disa elemente të rëndësishme:

- Qeveria e Kosovës duhet që, sa herë të hartojë politika të punësimit dhe rregullativa ligjore për këtë fushë, të konsiderojë shoqërinë civile si një sektor i cili ndikohet nga këto politika dhe duhet të përfshihet në zhvillimin dhe zbatimin e tyre, bashkë me sektorin publik dhe atë privat;
- Donatorët e shoqërisë civile, në veçanti donatorët e huaj, gjatë programimit dhe zbatimit të asistencës financiare për shoqërinë civile, duhet të jenë më fleksibil në mundësimin e fondeve të lira për organizatat e shoqërisë civile në raport me pagesën e pushimit të lehonisë sa herë që do të ketë nevojë;
- Organizatat e shoqërisë civile, në veçanti ato që pretendojnë të shndërrohen në institucione profesionale dhe të specializuara, duhet të angazhohen në rritjen e të ardhurave nga shërbimet, me qëllim që të sigurojnë fonde të lira për rastet kur femrat e punësuara në këto organizata shkojnë në pushim të lehonisë;
- Deri në gjetjen e zgjidhjes ligjore për këtë problem, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Inspektorati i Punës duhet të kenë parasysh natyrën specifike të funksionimit të organizatave të shoqërisë civile dhe pamundësinë reale të shumicës prej tyre për t'i zbatuar dispozitat e Ligjit të Punës për pushimin e lehonisë, dhe si të tilla t'i trajtojë rastet e këtij sektori në mënyrë të veçantë.

Mundësia e parë e trajtimit të këtyre elementeve është procesi i plotësim-ndryshimit të Ligjit të Punës. Paralelisht, qeveria, shoqëria civile dhe komuniteti i donatorëve duhet të thellojnë diskutimet dhe të dalin me zgjidhje konkrete që do të adresonte specifikat e sektorit civil dhe njëkohësisht do të eliminonte potencialin e diskriminimit të femrave të punësuara në këtë sektor.